



### NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

*Seancë plenare 27-30 prill 2015, Strasburg*

Parlamenti evropian i lejoi ndryshimet të rregullave për Fondin social evropian, me çka do të sigurohen një miliardë euro nga mjetet të UE-së për vendet-anëtare, për përkrahje të programeve për punësim të rinjve. Buxheti për Iniciativën evropiane për të rinj për periudhën 2014-2020 është 3,2 miliardë euro, ndërsa Fondi social evropian është burim kyç i financimit me rreth 86 miliardë euro.

Eurodeputetët debatonin për shpenzimet të mjeteve të Komisionit evropian dhe institucione dhe agjenci tjera të UE-së. Parlamenti ka të drejtë ekskluzive ta lejojë zbatimin e buxhetit të institucioneve të UE-së. Dyshimet të shprehura rreth revizioneve e nxitën parlamentin ta prolongojë lejimin e shpenzimeve të mjeteve evropiane nga viti 2013 për Institutin evropian për inovacione dhe teknologji. Eurodeputetët shprehën kritika edhe ndaj Komisionit evropian para së gjithash për gabime të shpenzimit në politikën e bujqësisë, rajonale dhe politikën e punësimit.

Shërimi eCall (thirrje elektronike) e cila në rast të fatkeqësisë në komunikacion automatikisht do ta ftojë shërbimin 112, prodhuesit do ta fusin në të gjitha modelet e reja të automjeteve dhe kombeve të lehta prej 31 mars 2018. Sipas rregullave të reja, nëpërmjet therjes automatike, shërbime për ndihmë urgjente do të kenë qasje të dhëna për llojin e automjeteve, lëndës djegëse, koha dhe vendi i saktë i fatkeqësisë të komunikacionit, numri i udhëtarëve në automjet

Në rezolutën të miratuar nga eurodeputetët, u kërkua shënimi i obligueshëm i vlerës kalorike të prodhimeve të cilat përmbajnë alkool.

Dëmet të krijuara si pasojë e konsumimit të tepruar të alkoolit në UE vlerësohet në rreth 155,8 miliardë euro në vitin 2010.

*seancë plenare 15 prill 2015, Bruksel*

Eurodeputetët miratuan rezolutë me të cilën ftuan për përpjekje më të mira për ndërprerjen e diskriminimit dhe fjalës së urrejtjes mbi Romët si dhe për njohmë 2 gusht për ditë memoriale të gjenocidit të Romëve në Luftën e Dytë Botërore.

Parlamenti i lejoi ndryshimet të Kornizës shumëvjeçare financiare të UE-së për vitet 2014-2020, me qëllim të ndihmohet financimi i 300 programeve në vendet-anëtare të UE-së. Me ndryshimet, mjetet të pashfrytëzuara nga viti 2014 në shumë prej 2.1 miliardë euro do të barten në vitet 2015-2017.

Në rezolutën të miratuar në 15 prill këtë vit, eurodeputetët ftuan në nevojën, Armenia dhe Turqia ta shfrytëzojnë njëqind vjetorin nga gjenocidi i Armenëve, për ripërtëritjen e marrëdhënieve diplomatike, hapja e kufirit dhe integrim ekonomik. Eurodeputetët dhanë respekt në 1,5 milionë Armenëve të cilit para 100 vjet qenkan viktimat të Perandorisë Otomane, me ç'rast propozuan të vendoset ditë ndërkombëtare e përkujtimit të gjenocidit mbi Armenët.

<http://www.europarl.europa.eu/news/en/news-room/plenary>

„  
Idea për Evropë të Bashkuar dhe shembulli i shteteve të Evropës perëndimore, duhet të jenë udhëzuesi jonë. Prosperiteti, interesat të përbashkëta, besimi dhe paqja doemos plotësisht të sundojnë edhe në të gjitha shtetet të Ballkanit. Ai është interesi jonë, por edhe interesi evropian... Dialogu politik, ndërmjet gjërave tjera, është një nga parimet kryesore mbi të cilat është krijuar Unioni Evropian.....”.

Një pjesë e fjalimit të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë z. Trajko Veljanovski në Konferencën e kryetarëve të parlamenteve të Unionit Evropian, 20-21 prill 2015, Romë, Republika e Italisë.....”.

#### Përmbajtja e lajmeve:

Në fokus të Parlamentit Evropian	1
Deklaratë e përbashkët për përforcimin e bashkëpunimit energjetik	2
Takim i Këshillit për punë të përgjithshme	3
Iniciativë qytetare evropiane 2015	4
Evropa për qytetarët+ -takim në Rigë	4
KE ngriti aktakuzë kundër Google	5
Agjendë e re evropiane për siguri	5
Ditë e planetit Tokë -2015	6
Dallime në çmimin e punës në UE	7
Rumania i zvogëlon tatimet	7
Propozime për emër të misionit të astronautit Tomas Peske	8
Kuota të anuluar për qumësht në UE	9
Takim i intergrupit të PE-së	9
Raport i Gjykatës Evropiane të revizorëve	10
UE kalendar/maj 2015	11

## E PËRBASHKËT PËR PËRFORCIM TË BASHKËPUNIMIT

### ENERGJETIK



Më 7 prill këtë vit në Budapest, ministrat për punë të jashtme të Hungarisë, Greqisë, Maqedonisë, Turqisë dhe Serbisë, mbajtën takim për stabilitetin energjetik në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Ministrat të pesë shtete u angazhuan për diverzifikim të burimeve dhe rutave për furnizim me gaz natyror si faktor kyç për furnizim të sigurt me energji në rajon.

Gjiganti energjetik rus Gazprom dhe partneri i tij turk Botas tashmë e shënoi trasën e gazpërçuesit, ndërsa marrëveshja ndër qeveritare pritet të jetë e nënshkruar në tremujorin e dytë të viti 2015.

Sipas vlerësimeve, faza e parë e gazpërçuesit parashikohet të përfundojë deri në fund të viti 2016. Sipas rutës, fillimi i gazpërçuesit është në bregun rus të Detit të Zi në afërsi të qytetit Anapa dhe vazhdon nën det. Pika e daljes në tokë do të jetë në afërsi të fshatit Kajakoj, ndërsa pika kryesore për dërgim të gazi për Turqinë do të gjendet në rajonin e Lulegurgaz. Gazpërçuesi nga Turqia do të dalë te qyteti Ipsal dhe do të vazhdojë nëpërmjet Greqisë.

**«Bashkëpunimi energjetik është me interes për qytetarët dhe industrinë, por do të ketë edhe rol kyç në përmirësimin e marrëdhënieve ndërfqinjësore ndërmjet shteteve në të cilat do të kalojë gazpërçuesi i ri - Rrjedha turke »**

Në takimin ishte miratuar Deklarata e përbashkët për përforsim të bashkëpunimit energjetik. Në deklaratën theksohet se bashkëpunimi energjetik është me interes për qytetarët dhe industrinë, por edhe do të ketë rol kyç në përmirësimin e marrëdhënieve ndërfqinjësore ndërmjet shteteve në të cilat do të kalojë gazpërçuesi i ri "Rrjedha turke".

Konkluzion kyç nga takimi është vendosja e grupi teknik e cila do të shqyrtojë arsyetim ekonomik dhe mundësinë për ndërtim të gazpërçuesi, i cili do të çoj gaz nga Turqia, nëpërmjet Greqisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Hungarisë, dhe te tregjet qendrore-evroplane.

Pjesa e gazpërçuesit i cili do të jetë nën det, kompania Gazprom do ta ndërtojë pavarësisht, ndërsa në realizimin e pjesës komponente nga projekti do të marrin pjesë edhe kompania turke Botas.

Sipas pritjeve, kapaciteti i "Rrjedhës turke" do mund të arrije 63 miliardë metra kub gaz në vit, që është baras me parashikimet të projekti "Derdhja jugore".

Me gazpërçuesin e ri, Turqia do të marrë rreth 16 miliardë metra kub gaz, ndërsa 47 miliardë metra kub gaz të tjerat janë të dedikuara për Evropën.


Projekti do të jetë i përfunduar deri në fund të vitit 2020, kur "Gazpromi" rus planifikon të ndërpres transportin e gazi nëpërmjet Ukrainës.

Projekti është i hapur për bashkëpunim me të gjitha vendet të cilat kanë interes.

Është kontraktuar në kohë më të afër të mbahet takim në nivel të ekspertëve dhe të përpilohet fizibiliteti studim për zhvillim të mëtejshëm të projektit me qëllim krijimin e infrastrukturës së nevojshme dhe mënyra e financimit.

Çdonjëra nga shtetet vlerëson se gazpërçuesi është në interes të ekonomisë nacionale, si dhe për tërheqje të investitorëve të huaj të ri, me ç'rast merret parasysh edhe roli i fondeve evropiane për zhvillim të projekteve të infrastrukturës në Evropën Juglindore dhe Qendrore.

<https://euobserver.com/energy/128261>



## KONKLUSIONE PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË — Ë PËRGJITHSHME TË UNIONIT EVROPIAN

Këshilli për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të UE-së, në 21 prill këtë vit në Luksemburg mbajti takim me të cilin kryesonte Edgars Rinkeviç, ministër i punëve të jashtme të Letonisë, vend i cili është kryesues aktual me UE-në. Ministrat e përshëndetën përcaktimin për veprim në lidhje me migrimin, veçanërisht në tre sferat kryesore: përforcimi i luftës kundër tregtisë me njerëz, përforcimi i aksioneve për shpëtim të kafshëve në det dhe përforcimi i bashkëpunimit me vende të treta.

Ministrat biseduan për prioritetet të Këshillit për marrëveshjen e ardhshme ndërinstitucionale për ligjvënien më të mirë të Unionit. Marrëveshja aktuale daton prej vitit 2003 dhe i përcakton parimet të përgjithshme të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit, Parlamentit Evropian dhe Komisionit. Qëllimi i marrëveshjes së re është të përmirësohet përpilimi i të drejtës të UE-së si dhe zbatimi i saj. Propozimi i Komisionit Evropian për marrëveshjen e re, pritet më 19 maj këtë vit.

Këshilli e shënoi dhjetëvjetorin nga nënshkrimi i marrëveshjes për qasje në UE, në Rumani dhe Bullgari.

Këshilli miratoi konkluzione pas raportit special të Gjykatës Evropiane të revizoreve, në lidhje me Fondin Evropian për zhvillim rajonal u jep përkrahje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sferën e e-tregtisë më efikase.

Në lidhje me Republikën e Maqedonisë, Këshilli në takim miratoi konkluzione me të cilat "shprehet brengje e madhe në lidhje me gjendjen e keqësuar në vend, veçanërisht në sferën e sundimit të të drejtës, të drejtat kryesore dhe lirisë së medieeve, të cilat janë vlera themelore demokratike në zemrën e UE-së dhe

politikat të zgjerimit.

Në interes të qytetarëve, demokracisë, sundimit të drejtësisë dhe stabilitetit politik, Këshilli i fton liderët politik për zgjedhje të shpejtë të problemeve. Këshilli i fton të gjitha palët të ndërmarrin masa urgjente për zgjidhje të qëndrueshme, përkushtim konstruktiv për restartimin e dialogut politik dhe kthim të besimit në institucionet me ndërmarrjen e hapave adekuate politike. Të gjitha akuzat duhet të hulumtohen nga na e organeve kompetente, duke përfshirë edhe konstatimet për keqpërdorime potenciale të shpallur publikisht, me respektim të plotë të procesit adekuat, parimi i pavarësisë dhe prezumcioni i pafajësisë.

Këshilli e përshëndeti meditimim e anëtarëve të Parlamentit Evropian në bisedimet ndërmjet partive kryesore në pushtet dhe të opozitës dhe i fton të dyja palët të tregojnë përmbajtje dhe të fokusohen në gjetjen e aktvendimit dhe të fokusohen në gjetjen e zgjedhjes të krizës së tashme politike sa është e mundshme më shpejtë.

Duke e reformuar nevojën për përkushtim të vazhduar të UE-së, duke përfshirë edhe nëpërmjet njoftimit të rregullt nga ana e Komisionit dhe të Shërbimit evropian për punë të jashtme, për situatën në vend dhe për përparimin e integritetit evropian, ndërsa në pajtim me konkluzionet të Këshillit prej 16 dhjetor 2014, Këshilli mbetet i përfshirë në lidhje me këtë çështje dhe do të kthehet në të njëjtën në muajt e ardhshëm".



*«Në interes të  
qytetarëve,  
demokracisë, sundimit të  
drejtësisë dhe stabilitetit  
politik, Këshilli i fton  
liderët politik për  
zgjedhje të shpejtë të  
problemeve»  
-një pjesë e  
konkluzioneve për  
Republikën e  
Maqedonisë*





Më 13 prill, në Bruksel u shënuar dita e Iniciativës Evropiane Qytetare. Ngjarja ishte e organizuar nga Komiteti evropian ekonomik-social në bashkëpunim me Komitetin e rajonit dhe Shërbimi evropian për aksione qytetare. Në fokusin e ngjarjes ishin perspektivat të lidhura me Iniciativën evropiane ndërkombëtare: raportet për zbatimin, shfrytëzuesit, vendet-anëtare, Parlamenti evropian dhe strukturat për përkrahje.

Iniciativa evropiane qytetare është njëherë me Marrëveshjen nga Lisbona dhe paraqet instrument më i rëndësishëm i demokracisë të drejtpërdrejtë në nivel evropian. Pas tre viteve nga futja, ishte kryer pikëpamjet të kornizës juridike, veçanërisht të Rregullativës 211/2011.

Në tre vitet e kaluara rreth 6 milionë qytetarë të Evropës dhanë përkrahje të Iniciativës Evropiane qytetare, me çka drejtpërdrejtë e shfrytëzuan zërin e tyre në tërheqjen e kujdesit të kreatorëve të politikave të UE-së.

Komisioni evropian më 31 mars shpalli

raport për zbatimin e këtij mekanizmi nga hyrja e tij në fuqi më 1 prill 2012.

Sipas raportit në tre vitet të kaluara ishin të pranuar 51 kërkesa për ngritje të iniciativës. Prej tyre, 31 qenkan në sferën ku ka kompetencë Komisioni Evropian, 3 iniciativa e kanë arritur pragun prej një milionë nënshkrime, 12 kanë përfunduar pa sigurimin e një milionë nënshkrime, për 3 ende grumbullohen deklarata për përkrahje dhe 10 propozime qenkan të tërhequra nga ana e organizatorëve.

Dita e Iniciativës Evropiane qytetare paraqet mundësi për takim dhe platformë për të regjistruar edhe organizatorë të ardhshëm të iniciativës për këmbim të përvojave dhe informata si dhe prezantimi i ideve të tyre të medieve.

<http://ec.europa.eu/citizens-initiative/>  
<http://www.citizens-initiative.eu/#home>  
<http://europa.eu/rapid/press-release>

## "EVROPA PËR QYTETARËT" - TAKIM NË RIGA



<https://eu2015.lv/>

Në takimin e përfaqësuesve të vendeve-anëtare të UE-së të cilat marrin pjesë në programin "Evropa për qytetarët" e cila u mbajt në 8 dhe 9 prill në Rigë, tema e bisedimeve ishin masat të cilat duhet të ndërmerren për përmirësimin e informatave dhe përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet partnerëve në projekt, me qëllim implementim më të mirë të programit. Përfaqësues të Komisionit Evropian dhe institucione tjera informuan për zhvillimin e ardhshëm të programit dhe u morën vesh për çështje kyçe në lidhje me përparimin e programit.

Përfaqësuesit të pikave për kontakt të programit "Evropa për qytetarët" takohen dy herë në vjet, me ç'rast çdo takim organizohet nga vendi i kryesuesit aktual me Këshillin e UE-së. ndër temat kryesore të diskutimit në takimet më së shpeshti janë gjendja aktuale dhe sfidat të programit, si dhe kërkesa të zgjedhjeve adekuate për përmirësim të kualitetit të saj.

programi "Evropa për qytetarët" krijohet për afrimin e UE-së të qytetarët, për përforcim të dimensionit evropian në shenjë të përkujtimit të ngjarjeve të rëndësishme historike dhe për zmadhimin e mundësive për pjesëmarrje të shoqërisë në proceset të UE-së, siguri i debati më të gjerë për çështjet të lidhura me UE-në në nivel lokal, rajonal dhe nacional.

programi paraqet mundësi organizatat qytetare dhe shoqëria më e gjerë të marrin pjesë në jetën demokratike të Unionit.

Takimi në Riga ishte në organizim të kontakt qendrës të UE programit "Evropa për qytetarët" në Letoni, por pika e kontaktit në Ministrinë e Kulturës të Letonisë në bashkëpunim me Agjencinë ekzekutive për kulturë, arsim dhe veprimtari audio vizuale të Komisionit evropian, e cila është organ qendror e programit.

[Click Here to upgrade to  
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

## KUNDËR GOOGLE DHE ANDROID

Komisioni evropian më 16 prill këtë vit oficalisht ngriti aktakuzë kundër kompanisë Google, për sjellje të monopoli dhe favorizim të serviseve të tyre, aplikimeve dhe sisteme operative.

Google do të ketë shans t'i kontestojë aktakuzat dhe të parashtrijë argument të saj kundër pohimeve të Komisionit.

Nëse Komisioni është në të drejtë, kompanisë i kërcënohet dënim i cili mund të arrijë edhe deri në 10% nga të hyrat vjetore ose rreth 6 miliardë dollarë në bazë të të dhënave financiare nga viti 2014. Në hetimin qenka shqyrtuar nëse kompania Google e cila ka 90% pjesë në internet kërkimet në tregun e Evropës, e ka shfrytëzuar pozitën dominuese që të arrihet konkurrenca në tregjet digjitale si dhe çmimet.

Komisari për konkurrencë i UE-së Margarete Vestager, pas bisedimeve me kryetarin e Komisionit Evropian Zhan-Klod Junker, miratoi vendim të ngrihet hetim.

Komisioni do të kontrollojë nëse Google ofron kushte jokuonkurente për prodhuesit të telefonave celular të cilët shfrytëzojnë aplikime të veta si YouTube. Akuza e parë ka të bëjë me rezultatet të cilat tregohen në Google gjatë kërkimit të krahasimeve për prodhime. Kompania akuzohet se në rezultatet e fanorizojnë

servisin e tyre Google Shopping me çka vërtetohet se ekziston kufizim të konkurrencës në llogari të serviseve personale dhe prodhimeve. Duke pasur parasysh përqindjen e madhe të shfrytëzimit të kërkuesit Google, përgjegjësia është në nivel më të lartë.

Akuza e dytë ka të bëjë me sistemin operativ Android. Komisioni e akuzon kompaninë se i kushtëzon prodhuesit të pajisjeve t'i shfrytëzojnë aplikacionet të tyre dhe të njëjtat të jenë paraprakisht të instaluar në pajisjen e tyre. Kufizohet ndryshimi i sistemit operativ i cili është me kod të hapur, kufizohet konkurrenca dhe zhvillimi i aplikacioneve të reja nëpërmjet kombinimit të aplikacioneve të tyre dhe servise me aplikacione tjera.

Hetimi i fundit më i madh i cili tërhoqi vërejtje ishte kompania Microsoft e cila ishte e akuzuar për përfshirjen të Internet Explorer me sistemin e tyre operativ Windows në kohën kur ai ishte masovikisht i shfrytëzuar.

<http://ec.europa.eu/competition/>  
<http://www.telegraph.co.uk/finance/>



---

*«Nëse Komisioni Evropian është në të drejtë, kompanisë Google i kërcënohet dënim e cila mund të arrijë edhe deri në 10% nga të hyrat vjetore ose rreth 6 miliardë»*

## AGJENDË E RE EVROPIANE PËR SIGURI

Më 28 prill këtë vit Komisioni Evropian i vendosi Agjendën Evropiane për siguri për periudhën 2015-2020, me të cilën do të përkrahet në bashkëpunimin ndërmjet vendeve-anëtare në luftën kundër terrorizimit, krimin të organizuar dhe krimin kibernetik.

Me programin janë përcaktuar masa konkrete të cilat së bashku do të shfrytëzohen me qëllim arrijtjen e ballafaqimit të sigurt dhe efikas me tre çështjet e dhimbshme.

Për sigurimin e sigurisë së brendshme janë përgjegjëse vendet-anëtare, ndërsa sfidat tejkuftare janë tepër të mëdha që të mund vende të veçanta në mënyrë të pavarur të veprojnë. Për këtë shkak është e nevojshme përkrahje në UE për ndërtim të besimi dhe lehtësim të bashkëpunimit, këmbim të informatave dhe veprim i përbashkët.

Aktivitete kyçe nga agjenda e re për siguri janë: luftë kundër radikalizmit, azhurnimit të kornizës juridike për terrorizëm, parandalim të financimit të krimin, përforsim të dialogut me industrinë informatike, përforsim i kornizës juridike për armën të zjarrit, përforsim i veglave për luftë kundër krimin kibernetik dhe të kapacitete të Europolit.

Sipas hulumtimit të ri të Eurobarometrit, qytetarët evropian më shumë janë të brengosur për sigurinë e tyre. Përqindja e personave të cilit konsiderojnë se terrorizmi është kërcënim kryesor për sigurinë e UE-së, në vitin 2013 qenka 33%, ndërsa sot është rritur deri në 49%.

[http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-4865\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-4865_en.htm)



Republika e Maqedonisë edhe këtë vjet u bashkëngjit në shënimin e Ditës të planetit Tokë - 22 prill, me organizimin e ngjarjeve të shumta dhe manifestimeve.



Në 22 prill këtë vit shënohet 45 vjetori i krenimit të ditës së planetit tokë. Ideja për shënimin e kësaj dite rrjedh nga senatori i mëparshëm amerikan nga shteti Viskonsin, Gejlord Nelson i cili në vitin 1969 qenka dëshmitar i lëshimit masiv të naftës në Santa Barbara, Kaliforni. I inspiruar nga lëvizja masive antiushtarake e studentëve në atë kohë, energjia e re e cila vetëdijen publike për ndotjen e ajrit dhe ujit ka arritur ta drejtojë nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit jetësor në agjendës politike nacionale. Si rezultat i asaj, 20 milionë Amerikan më 22 prill kanë dalë në rrugët dhe parqet me demonstrata për mjedis jetësor të shëndosh dhe të qëndrueshëm. Mijëra kolegje dhe universitete kanë organizuar protesta kundër ndotjes të mjedisit jetësor.

shënimi i parë i Ditës së planetit Tokë solli në formimin e Agjencisë për mjedis jetësor të SHBA-ve si dhe te miratimi i ligjeve për ajër të pastër, ujë të pastër dhe lloje të kërcënuara.

Në vitin 1990m dita e plantës Tokë është shënuar me mobilizimin e 200 milionë njerëz prej 141 vende, me çka çështja për mbrojtje të mjedisit jetësor është vendosur në skenën botërore. Në vitin 1995, kryetari i atëhershëm i SHBA-ve Bill Klinton, e ka ndarë mirënjehjen më të madhe të nderi - medaljen të kryetari të lirisë, senatorit Nellson për rolin e tij si themelues në Ditën e planetit Tokë.

Kombet e Bashkuar në Konferencën për mjedisin jetësor në vitin 1992, 22 prill në mënyrë oficiale e kanë shpallur për Ditë të planetit Tokë.

Këtë vit në Berlin, prej 19-23 prill ishte mbajtur "Java globale e tokës", ku shkencëtarët nga Qendra e përbashkët e hulumtimit të Komisionit Evropian e prezanton punën e vet në tokën e cila është me rëndësinë kyçe për jetën në Tokë. Ishin paraqitur mekanizma të reja dhe qasje si dhe të dhënat të tokës të cilat do të jenë të futura në politikat adekuate me qëllim sigurimin e tokës së shëndoshë për gjeneratat të ardhshme.

Marrëveshja e parë ndërkombëtare e rëndësishme për ndryshimet klimatike është miratuar në vitin 1997 (Protokolli i Kjosos), i cili nuk ishte i ratifikuar nga ana e SHBA-ve. Pas njëzet vjet përpjekje të pasuksesshme për krijimin e marrëveshje efikase ndërkombëtare për ndryshimet klimatike, pritjet janë se këtë vit në konferencën në Parisë, liderët botëror përfundimisht do të arrijnë pajtim për miratimin e protokollit të ri për ndryshimet klimatike.

Në Zyrën popullore të Kryetarit të Republikës së Maqedonisë ishte vendosur ekspozitë e mineraleve dhe kristaleve nga vendi.

Në qytetin e Shkupi ishin organizuar një sërë aktiviteteve dhe aksione me porosi për paqe dhe për mjedis më të pastër jetësor. Pjesëmarrësit më të mirë ishin fëmijët nga çerdhet dhe shkollat, dhe për herë të tretë u mbajt manifestimi sportiv "Roler-garë 2015", nën moton "Voziti kah ardhmëria" në të cilën morën pjesë 700 nxënës nga shkollat në qytet dhe nga rrethina e Shkupit.

Bordi organizativ i të rinjve në Ambasadën e Amerikës, së bashku me fëmijët nga SHF "Ismail Qemali" e pastronin oborrin e shkollës dhe mbollën drunj të rinj. Nxënësit nga SHF "Goce Dellçev" në Shkup defiluan me maska nga materiale ekologjike.





[Click Here to upgrade to  
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

## VENDET—ANËTARE TË UE-SË

Shpenzimet mesatare të forcës së punës në vitin 2014 në ekonominë e UE-së, me përjashtim të bujqësisë dhe administratës publike vlerësohen në 24,6 euro në orë dhe 29,2 euro në eurozonë.

Çmimi i punës është më e ulët në Bullgari, ndërsa më e shtrenjtë në Danimarkë. Sipas sektorëve, shpenzimet për forcë të punës më të larta janë në industri. Shpenzimet për forcë të punës në UE në vitin 2014 janë për 1,4% më të mëdha në krahasim me vitin 2013.

Dallimet të çmimit të punës në vendet-anëtare të UE-së janë të mëdha. Sipas vlerësimeve të tyre të Shërbimit evropian për statistikë shpenzime më të ulëta për forcë të punës janë në Bullgari (3,8 euro për orë), Rumani (4,6 euro), Lituani (6,5 euro) dhe Letoni (6,6 euro), ndërsa më të mëdha në Danimarkë (40,3 euro), Belgjik (39,1 euro), Suedi (37,4 euro) dhe Luksemburg (35,9 euro).

Shpenzimet për forcë të punës për orë, më të larta janë në sektorin industri - 25,5 euro në UE dhe 32 euro në eurozonë, mandej në sektorin e shërbimeve (24,3 përkatësisht 28,2 euro) dhe në ndërtimtari (22 përkatësisht 25,8 euro).

Në pjesën joproductive të ekonomisë, me përjashtim të administratës shpenzimet për forcë të punës në vitin 2014 qenkan 24,7 euro në orë në UE dhe 29,1 euro në eurozonë. Kjo pjesë e ekonomisë është 24% nga çmimi i përgjithshëm i punës dhe i përfshin arsimin, shëndetësinë, punët sociale, artin, rekreacion dhe veprimtari tjera të shërbimit.

Shpenzimet të punës (të shprehura në valutën nacionale), rritje më të madhe në vitin 2014 në krahasim me vitin 2013 kanë në Rumani (6%), Lituani dhe Poloni (3,5%) dhe Hungari (3,3%) ndërsa rritje më të ulët qenka vërejtur në Danimarkë (0,9) dhe Britani të Madhe (1,3%). Sipas Eurostat, zvogëlimi i shpenzimeve për forcë të punës për orë është vërejtur vetëm në Kroaci - 0,8%.

<http://ec.europa.eu/eurostat/>



## RUMANIA I ZVOGËLON TATIMET

Rumania planifikon këtë vit ta zvogëlojë tatimin mbi vlerën e shtuar për ushqim dhe pije joalkoolike me qëllim të stimulohet punësimi dhe t'u ndihmohet qytetarëve më të varfër. Planifikohet zvogëlimi gradual edhe i shkallëve tjera tatimore nga viti 2019.

Kryeministri i Rumanisë Viktor Ponta, pret deficit buxhetor si rezultat i zvogëlimit të shkallës tatimore të kompensohet me pagesë më të mirë të tatimeve.

Zvogëlimi i TVSh-së për ushqim në 9% prej 24%, shpjegohet me nevojën t'u ndihmohet të shtresave të varfra në vend. Sipas versionit të ri të ligdhënës tatimore, TVSH-ja do të zvogëlohet në 24% në vitin 2016 deri në 20%, ndërsa për prodhimet si mishi, peshku, perimet, pemët, prodhimeve të qumështit, kafshëve, shpezëve dhe vezëve, deri në 9%. Nga viti 2018 TVSH-ja do të zvogëlohet prej 20% në 18%. Zvogëlimi i parë i TVSH-së duhet të hyjë në fuqi më 1 janar të këtij viti. Zvogëlimi do ta kushtojë buxhetin pesë miliardë lei ose rreth 1,23 miliardë dollarë.

Qeveria prej për zvogëlimin gradual të tatimeve, parlamenti të jep pajtim deri në fund të korrikut.

Ndërmarrjet të vogla është paraparë të paguajnë shkallë të diferencuara të tatimit mbi fitim, në varësi nga

numri i të punësuarve. Qeveria ka qëllim t'i zvogëlojë akcizat të lëndës djegëse, duhanit, pijeve alkoolike, ndërsa akciza e mazutit i prodhuar në Rumani, prodhime nga kafeja, stoli ose automjetet dhe tatimi në ndërtimtari do të mund të hiqen.

Këshilli fiskal i Rumanisë paralajmëron se zvogëlimi i planifikuar i tatimeve bazohet në vlerësime tepër optimiste të të hyrave dhe paraqet "rrezik i madh" për financat të shtetit. Këshilli vlerëson se deficitin fiskal në vitin 2016 do të zmadhohet në 3,1% të BPV-së,

Sipas Këshillit fiskal, deficitin strukturor do të hipet në 5,5% deri në vitin 2019 përkundër 1% të projektuar me çka arritja e qëllimit të futjes së euros në vitin 2019 do të jetë e mundur, duke pasur parasysh deficitin e madh.

<http://uk.reuters.com/article/2015/>



Në nëntor të vitit 2016 pritet astronauti i Agjencisë Evropiane kozmike, Tomas Peske të fluturojë me anijen kozmike "Sojuz" si pjesë e ekspeditës të përbërë prej 50 anëtarë, së bashku me astronautin nga NASA Pegi Vitson dhe komandimi - kozmonauti rus Oleg Novicki.

Organizata evropiane kozmike (ESA) dhe astronauti Tomas Peske drejtuan ftesë te qytetarët për dorëzim zë propozimeve për emrin e misionit - kërkohet e shkurtë, e thjeshtë, emër i tingëllueshëm i cili lehtë do të shqiptohet në gjuhën frënge, angleze dhe gjuhë të tjera.



Agjencia evropiane kozmike paraqet portal i Evropës deri te kozmosi. Si organizatë ndërkombëtare, është krijuar në vitin 1975 me misin ta formojë zhvillimin e mundësive të hapësirës evropiane dhe të sigurojë investim në kozmos në dobi të qytetarëve të Evropës dhe botës.

Në ESA marrin pjesë 20 shtet: Austria, Belgjika, Çekia, Danimarka, Finlanda, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia,

Polonia, Portugalia, Rumania, Spanja, Suedia, Zvicra dhe Britania e Madhe.

Në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta për bashkëpunim Kanada merr pjesë në projekte të caktuara. Marrëveshja për bashkëpunim me ESA kanë nënshkruar dhjetë shtete: Polonia, Izraeli, Estonia, Rumania, Sllovenia, Qiproja, Letonia, Lituania, Sllovakia dhe Bullgari.

Selia e ESA është në Paris, ndërsa qendra të ndryshme për: astronautë, operacione kozmike, hulumtim kozmik dhe telekomunikacion ka në më shumë shtete evropiane: Gjermani (Keln dhe Darmshtad), Spanjë (Vilaneva de la Kanada), Italia (Fraskati), Holanda (Nordvijk), Britania e Madhe (Harvel-Oksfordshir) dhe Belgjik (në regjionin Ardenes).

<http://thomaspesquet.esa.int/>  
<http://www.esa.int/ESA>

Tomas Peske është i lindur në vitin 1978, në Ruan-Francë. Në vitin 2001 ka magjistruar në École Nationale Supérieure de l'Aéronautique et de l'Espace në Tulluz-Francë, në seksionin dizajn dhe kontroll të anije kozmike.

Në vitin 2006 ka diplomuar edhe në shkollën për fluturim Air France. Tomasi është anëtar i Asociacionit francez për aeronautikë dhe astronautikë dhe anëtar i Institutit Amerikan për aeronautikë dhe astronautikë.

Në vitin 2009 është zgjedhur për astronaut në Agjencinë evropaien kozmike. Në vitin 2010 e ka përfunduar trajnimin dhe punën në Eurocom - në komunikacione me astronautë gjatë fluturimeve në kozmos. Qenka përgjegjës për projektet të ardhshme në Qendrën evropiane për astronautë.

Ka marrë trajnime plotësuese operative dhe teknike në Evropë, Rusi dhe SHBA.

Në nëntor të vitit 2016, Tomas Peske do të fluturojë në mision gjashtë mujor në kozmos si inxhinier i fluturimit për ekspeditat 50 dhe 51. Misioni duhet të përfundojë në maj të vitit 2017. Tomasi do të punojë në eksperimente për qëllime shkencore në interes të përmirësimit të jetës dhe hulumtim të sistemit tonë diellor.





[Click Here to upgrade to  
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

## ONIN EVROPIAN

Komisioni Evropian, pas më shumë se 30 vjet, prej 1 prill i anulohet kuotat për prodhimtari të qumështi. Prodhuesit në Evropë do të mund të prodhojnë qumësht në sasi të pakufizuara. Sipas vlerësimeve në vitin 2015 prodhimtaria e qumështit do të stagnojë.

Në Unionin Evropian në gjashtë vitet të ishin humbur 200.000 ferma për prodhimin e qumështit. Edhe krahas prodhimtarisë në Francë dhe Gjermani, Unioni e humb betejën të lideri eksportues me Zelandën e Re.

Në Unionin Evropian në vitin 2014 qenkan të mbledhur 151 miliardë lira qumësht prej rreth 660.000 ferma. Për vitin 2015 edhe krahas anulimit të kuotave parashikohet prodhimtari e pandryshuar.

Kampionit evropian në prodhimtari të qumështi është Gjermania me më shumë se 30 miliardë litra në vitin 2014, sipas të dhënave të Qendrës për përcjelle të sektorit të qumështit në Komisionin Evropian. Mandej vijon

Franca me 23 miliardë litra, Britania e Madhe me 14 miliardë litra, Holanda, Italia dhe Polonia.

Konkurrent më i madh i UE-së me eksport prej 1.887 miliardë qumësht në vit, në lloj të buteri dhe qumësht në pluhur janë Zelanda e Re, SHBA, Australia, Argjentina dhe Bjellorusia. UE ende është eksportues më i madh i qumështi të papërpunuar në pluhur me rritje të eksportit prej 59% në vitin 2014.

Komisioni evropian paralajmëroi se do ta përcjellë situatën nga kërcënime të mundshme për sektorin qumështit pas anulimit të kuotave.

Politika e përbashkët bujqësore e UE-së vendeve-anëtare u siguron vegël për zbutje të pasojave negative në formë të ndihme ose fonde për zhvillim të bujqësisë.

Komisioni do ta përforcojë Qendrën për përcjellje të sektorit të qumështit i themeluar në vitin 2013, që t'i ndihmojë sektorit më mirë të përgjigjet në ndryshimet të tregut.

<http://www.euractiv.com/sections/agriculture-food/>



## TAKIM I INTERGRUPIT TË PE PËR INVESTIM AFATGJAT DHE REINDUSTRIALIZIM

Në 13 prill në Komitetin evropian të regjioneve ishte mbajtur mbledhje inaguruese të intergrupit të Parlamentit Evropian për investim afatgjatë dhe reindustrializim të Fondit evropian për investime strategjike (i ashtuquajtur Plani i Junkerit).

Kryetari i komitetit Marku Markulla e përsëriti angazhimin e regjioneve dhe qyteteve në Evropë për zbatimin e planit investues dhe ftojë për rol më të fortë të platformave regjionale për investime.

Ngjarja ishte e mbajtur disa ditë para miratimit të Raportit të parlamentit evropian, për Fondin evropian për investime strategjike dhe fillimi i bisedimeve ndërmjet Këshillit dhe Komisionit Evropian.

Për momentin në Intergrupin marrin pjesë rreth 70 anëtarë të parlamentit evropian, me përkrahje të rreth 30 shoqatave profesionale dhe palë të interesuara.

Grupi është krijuar me qëllim të mbahet dialog i rregullt me aktorët kyç dhe të nxitet debati për investime afatgjate dhe korniza ligjvënese.

Sipas vlerësimeve të Komisionit, plani investues do të mund ta zmadhojë BPV-në e UE-së deri në 410 miliardë euro dhe të krijojë deri në 1,3 milionë vende të reja të punës.

<http://longterminvestment.eu/>





*“Mekanizmi i njohur si “Garanci për të rinjtë” ka për qëllim për 7,5 milionë të rinjë të papunësuar në UE t’u sigurojë mundësi për punësim, arsim ose trajnim»*

Papunësia te të rinjtë është një nga sfidat kryesore me të cilën ballafaqohen shumica e vendeve-anëtare të Unionit Evropian. Si përgjigje në këtë sfidë në qershor 2013 Unioni vendosi mekanizëm të njohur si "Garanci për të rinjtë" e cila ka për qëllim për 7,5 milionë të rinj të papunësuar të sigurojë mundësi për punësim, arsim ose trajnim.

Gjykata evropiane e revizorëve në 24 prill 2015 shpalli raport në të cilën janë përcaktuar tre rreziqe për zbatim të suksesshëm të UE iniciativës "Garanci për të rinjtë": për mënyrën adekuate të financimit të përgjithshëm, për definicionin e "ofertës kualitative" dhe për mënyrën në të cilën Komisioni Evropian i përcjell dhe njofton për rezultatet nga programi.

Sipas revizorëve, Komisioni ka siguruar përkrahje në kohë dhe adekuate të vendeve-anëtare në vendosjen e programit "Garanci për të rinjtë". Megjithatë, Komisioni nuk ka zbatuar vlerësim të ndikimit dhe nuk i ka theksuar shpenzimet të pritura dhe përfitimet, duke pasur parasysh se ajo është procedurë standarde për të gjithë iniciativat kryesore të Komisionit.

Mungojnë informata për shpenzimet e përgjithshme të mundshme për parandalim të programit në nivel të UE-së dhe ekziston rrezik shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të mos jetë adekuate. Nuk është qartë e definuar çka saktë nënkuptohet nën temën ofertë "kualitative" për punë.

Sipas statistikave, çdo pesë qytetarëve të UE-së në moshë nën 24 vjet të cilit gjenden në tregun e punës për më shumë se një nuk ka punë, ndërsa në disa nga vendet-anëtare është i papunësuar çdo person i dytë i ri. Në periudhën prej vitit 2014 deri në vitin

2020 programi pjesërisht do të financohet nga buxheti i UE-së nëpërmjet Fondit evropian social dhe iniciativa të veçanta për punësim të të rinjve në shumë prej 12,7 miliardë euro.

Vendet-anëtare duhet të sigurojnë mjete plotësuese për financim të masave për punësim, por edhe për masa të lidhura me reformat strukturore të sistemeve për trajnim, arsim dhe mundësit për punësim të njerëzve të rinj. Shuma e mjeteve nacionale për këtë program nuk është përcaktuar, nëntë vende-anëtare ende nuk kanë dorëzuar të Komisioni informata për këtë çështje, ndërsa vendet tjera anëtare kanë dorëzuar disa informata.

Në raportin të revizorëve janë dhënë rekomandime:

vendet anëtare të sigurojnë pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të shpenzimeve të të gjitha masave të planifikuara për luftë kundër papunësisë te të rinjtë;


Komisioni të promovojë set të kushteve kualitative të cilat ofertat për vende të lira të punës, stazhimi dhe praktikës përgatitore duhet t'i kenë që t'i plotësojnë kushtet për përkrahje nga UE-ja;

Komisioni duhet të vendos sisteme gjithëpërfshirëse për përcjellje të programit e cila do t'i përfshijë edhe reformat strukturore dhe masat. Për rezultatet nga përcjellja e programit, duhet të informohen Parlamenti Evropian dhe Këshilli.

<http://www.eca.europa.eu/en/Pages/NewsItem.aspx?nid=5715>

Click Here to upgrade to  
Unlimited Pages and Expanded Features

## Overview of the funding of the Youth Guarantee




Source: ECA.



### UE KALENDAR/ maj 2015

1. EHRO Milano 2015 prej 1 maj deri më 30 tetor 2015
2. Prognoza Evropiane Ekonomike në Pranverë - shpall Komisioni Evropian, më 5 maj, Bruksel
3. Shënimi i Ditës së Evropës - 9 maj (institucionet të UE-së në Bruksel, Strasburg dhe Luksemburg më 2 dhe 9 ma 2015 janë të hapura për vizitorë).
4. Seancë plenare e Parlamentit Evropian, 18-21 maj 2015, Strasburg,
5. Shënimi i Ditës së klimës dhe financave - 22 maj 2015, Paris.



European Union Newsroom

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic:

By organiser:

By type:

BY MONTH

No	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

All forthcoming events

Today | Next 7 days | Next 30 days | Next 365 days

21 Mon | 31 Thu

Other bodies and agencies, Events (Ond)/Fairs, Science and technology

ESA-JRC International Summer School on GNSS 2014

Help us improve

Find what you wanted?

Yes No

What were you looking for?

Any suggestions?

Send

Last update: 30/07/2014 | Mobile | RSS | Sitemap | About this site | Legal notice | Cookies | Contact | Top





Your complimentary  
use period has ended.  
Thank you for using  
PDF Complete.

[Click Here to upgrade to  
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

## KUVENDI I REPUBLIKES SE MAQEDONISE

### UE QENDRA E KUVENDIT

ADRESA 11 Tetor nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: [nsei@sobranie.mk](mailto:nsei@sobranie.mk)

Zyra 019

---

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

---

*Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforsimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.*

*Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të UE qendre në Kuvend.*

*Qëllimi i formimit të UE qendrës është deputetëve në*

---